



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.205/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dhe Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën dhe Lista Ideal, me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 29.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohen të bazuara ankesa e subjektit politik koalicioni Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dhe Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën dhe Lista Ideal, me seli në Prishtinë, Anr.205/2025 dhe Anr.207/2025 e datës 26.01.2025, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,500.00 (pesëmijepesëqind) euro.
- II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 26.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr. 205/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe ankesën Anr. 207/2025 nga subjekti politik koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën dhe Lista Ideal, me të cilën pretendojnë se më datë 25.01.2025, subjektit politik LVV, ka mbajtur fushatën zgjedhore në qytetin e Malishevës, përkatësisht në Palestrën e Sportit, duke filluar nga ora 18:00 e njëjta në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka penguar gazetarët

në kryerjen e detyrave të tyre profesionale, me ç' rast gjatë pengimit të tyre kanë përdorur edhe gjuhë që nxitë apo ka mundur të nxisë dikë që të përdorë dhunë apo të nxisë urrejtje. Tutje parashtruesi i ankesës ka cekur nenin 34, paragrafi 1.5 të LZP-së i cili përcakton “*pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale*”, tutje në paragrafin 1.11 përcaktohet “*përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se gjatë këtij incidenti, zyrtarë të VV-së i janë drejtuar me pyetjet “Çka keni lyp me ardh këtu?”, madje gazetares i kanë thënë “Ju jeni ma zi se të Serbisë” dhe për t’ia pamundësuar prezencën e tyre në fushatë, ata i kanë kërkuar dhe leje specifike, veprim totalisht i kundërligjshëm. Po ashtu, parashtruesi i ankesës ka theksuar se për këtë rast ka reaguuar Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), duke e quajtur veprimin të “papraneueshëm” dhe që “rrezikon seriozisht sigurinë fizike të gazetarëve të këtij mediumi”. Po ashtu në ankesë është theksuar se një ngjarje e tillë është e paprecedentë në garat politike të cilat zhvillohen në vendin tonë dhe si rrethanë të tillë, si preventivë që të mos përsëritet asnjëherë një ngjarje e tillë, që është e shëmtuar për një vend demokratik, gjoha duhet të jetë sa më e lartë. Përmes ankesës ka kërkuar që pas shqyrtimit të rrethanave faktike dhe juridike të lartcekura, që ankesa të aprovohet në tërësi si bazuar dhe në pajtim me ligjon e aplikueshëm, LVV t’ia shqiptojë gjobën e merituar.

Si provë kanë bashkangjitur CD dhe një link <https://nacionale.com/video/cka-keni-lyp-me-ardh-ktu-ju-jeni-ma-zi-se-te-serbise-gazetarja-e-nacionales-pengohet-ne-tubimin-e-vv-se-ne-malisheve>

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 28.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur dhe atë për faktin se e njëjta vetëm tekstualisht mbështete në fakte, ndërsa nga provat materiale të bashkangjitura evidentojmë vetëm njoftimin për tubimin e mbajtur nga LVV, më tutje në përgjigje në ankesë pretendon se subjektet politike ankuese kanë dështuar në mbështetjen e ankesës në dëshmi të qarta dhe bindëse, ashtu siç e parasheh ligji për paraqitjen e ankesës, duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, i LZP-së, dhe se në mungesë të provave, e cila do ta bënte subjektin politik LVV përgjegjës, është i pamundur arsyetimi e pretendimeve për arsye se nuk është qartë se çka është objekti i ankesës, andaj kërkojnë nga PZAP-i që ankesën ta hedhë si ta pa lejuar.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.205/2025, dhe A.nr.207/2025 janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.205/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara kundër të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe ideo incizimit të ofruar si dëshmi ka vërtetuar se subjektit politik LVV, me datën 25.01.2025 në ora 18:00 ka mbajtur fushatën zgjedhore në qytetin e Malishevës, përkatësisht në Palestrën e Sportit, dhe gjatë mbajtjes së tubimit mbështetësit përkatësisht organizatorët e këtij subjekti në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kanë penguar gazetarët në kryerjen e detyrave të tyre profesionale, me ç ‘rast gjatë pengimit të tyre subjekti politik LVV ka shkelur nenin 34, paragrafi 1.5 të LZP-së i cili përcakton se: *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale*”.

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 29.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse veprimet e tilla janë kundërshtim me nenin ka shkelur dispozitën ligjore të lartcekur të LZP-së.

Paneli gjeti se për shkeljen e bërë nga subjekti politik LVV ka reaguar edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës nga ku shihet se të njëjtat kanë reaguar për pengimin që ju është bërë gazetarëve të gazetës Nacionale gjatë tubimit zgjedhor të mbajtur në Malishevë.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektimit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se veprimet e tilla të subjektit politik LVV , është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e 34, paragrafi 1.5 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi i tillë paraqet shmangie për të promovuar mbrojtjen e gazetareve dhe akterëve tjerë të medias gjatë kryerjes së detyrave të tyre, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pambështetëse ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5) nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 205/2025 më datë 29.01.2025

**Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi palët kanë te drejte ankese ne Gjykatën Supreme brenda 48 orëve nga momenti i pranimit, konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.